



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:049861
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05714273

Ac.nr.2105/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B..... Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë e përfaqësuar nga L..... V....., kundër të paditurit R..... Ll..... nga fshati Surkish Komuna e Podujevës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. B..... S..... nga Podujeva, për rimbursim dëmi, vlera e kontestit 1,238.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.822/20, të datës 02.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e bazuara ankesa e të paditurit R..... Ll....., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.822/20, i datës 02.02.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar 822/20 të datës 02.02.2021, në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar pjesësisht padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë si të bazuar dhe e ka detyruar të paditurin R.....Ll..... nga fshati Surkish, Komuna e Podujevës, që t'ia kompensoj paditëses me përgjegjësi prej 70% përgjegjës, i padituri me 30% përgjegjës, shumën prej 866.6 euro në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 14.03.2009 në Podujevë, me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat afariste të Kosovës për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që shumën prej 866.6 euro për rimbursim dëmi t'ia paguaj paditëses në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij

aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë, ndërsa në pikën e tretë të dispozitivit e ka detyruar secilën palë që ti bart shpenzimet procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i padituri, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e goditur me ankesë dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195, paragrafi, 1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e të paditurit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, me datë 14.05.2012 ka ushtruar padi për rimbursim dëmi kundër të paditurit R.... Ll..... nga fshati Surkish, Komuna e Podujevës për shkak se me datë 14.03.2009, i padituri kishte shkaktuar aksident duke drejtuar automjetin e tij Audi 80 me targa 485-KS-600 të cilin e kishte të pa siguruar dhe pa regjistruar. Meqenëse paditësja e kishte kompensuar palën e dëmtuar atëherë konform rregullit 3 të BQK-së ka të drejtë të kërkoj këtë shumë nga i padituri.

I padituri, në përgjegje në padi e kishte kundërshtuar në tërësi kërkespudinë e paditëses me propozimin që e njehta të refuzohet si e pabazuar ngase i padituri nuk e ndjen vehten fajtor për këtë aksident sepse vetë fëmiu ka qenë fajtor dhe i ka ikur nënës së tij prej dore dhe me ka dal në një distancë shumë të afërt edhe pse unë isha me shpejtësinë minimale duke vozitur.

Kjo çështje ishte rigjykar për shkak se gjykata e apelit e kishte prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për tu vërtetuar baza juridike dhe kontributi në shkaktimin e aksidentit.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë ekspertizën e komunikacionit dhe paditësja ka qënduar pranë kërkespadisë duke kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të rimbursimit të dëmit t'ia paguaj paditëses shumën prej 1.238,00 euro.

I autorizuari i të paditurit ka deklaruar se padia është e pa mbështetur në prova konkrete, ku përveç raportit policor i cili e bën vetëm përshkrimin e rastit, padia nuk gjen mbështetje as në vendim gjyqësor sa i përket fajësisë apo kontributit të pjesëmarrësve në këtë aksident. Me një ekspertizë shabllone ku sipas mendimit të ekspertit thuhet se lëshimet e ngasësit të automjetit "A" janë kinse mospërshtatje e shpejtësisë sipas kushteve në rrugë dhe rrethanave të krijuara në komunikacion, ndërsa për rastin konkret bëhet fjalë për aksidentin e ndodhur në qendër të qytetit me frekuentim të madh të njerëzve – ditë tregu ora 13:20, andaj zhvillimi i shpejtësisë së madhe nuk ishte i mundur. Fëmiu i ka ikur nënës së tij nga dora dhe përplasat për automjetin e paditurit. Po ashtu kemi të bëjmë dhe me parashkrim sepse aksidenti ka ndodhur në vitin 14.03.2009 kurse

padia është ushtruar në vitin 14.05.2012, pra pas më shumë se 3 vitesh, kurse bazuar në dispozitat e LMD-së kërkesat e siguruesit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për 3 vite. Po ashtu i padituri i përket gjendjes së vështirë ekonomike, i pa punë me bashkëshorte e cila vuan nga një sëmundje e rëndë për më shumë se 10 vite. Andaj i propozon gjykatës që ta refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar dhe të detyrohet për kompensimin e shpenzimeve të procedurës për përfaqësimin e rastit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.822/20 të datës 02.02.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se nga ekspertiza e komunikacionit e datës 16.10.2020 të hartuar nga eksperti i komunikacionit Sejdi Berisha nga Prishtina gjykata vërteton faktin se aksidenti ka ndodhur si pasojë e lëshimeve të dy pjesëmarrësve në aksident të të paditurit dhe këmbësorit – fëmiut të mitur A.... I..... nga fshati Bradash, Komuna e Podujevës. Nga procesverbalet e kësaj gjykate C.nr.229/2009 dhe provat mjekësore vërtetohet se pala e dëmtuar në aksident ka marrë lëndime trupore vlerësim i ekspertëve mjekësorë nga lëmit përkatëse. Lëshimet e të paditurit i cili e drejtonte automjetin Audi 80 me targa 485-KS-600 konsistojnë në mos përshtatjen e shpejtësisë sipas kushteve dhe rrethanave të krijuara në komunikacion dhe mos kujdesi dhe jo vigjilencë e ngasësit. Ndërsa lëshimet e këmbësorit – fëmiut të mitur ishin: pakujdesia gjatë kalimit të rrugës (kalimi pa mbikëqyrjen e personit madhor), andaj sipas ekspertit të komunikacionit lëshimet e të paditurit ishin primare dhe shkaktar i aksidentit ndërsa këmbësori – fëmiu i mitur (i moshës 3.3 vjeç) i ka dhënë kontribut aksidentit - pra ka përgjegjësi sekondare. Meqenëse u vërtetua se dy pjesëmarrësit në aksident mbajnë përgjegjësi atëherë gjykata me zbatim të dispozitave të LMD-së e ka ndarë përgjegjësinë siç u përcaktua eksperti për të paditurin i cili mban përgjegjësi primare në shkaktimin e aksidentit me 70% të përgjegjësisë dhe fëmiu i mitur për 30% apo kontribut sekondar. Me rastin e shkaktimit të aksidentit nga i padituri dhe përgjegjësië së tij për 70% si kontribut primar në shkaktimin e aksidentit e vërtetuar me ekspertizën e komunikacionit, këtu paditësja (atëherë e paditura) ka qenë e obliguar sipas dispozitës së Rregullit 3 të BQK-së t'ia kompensoj dëmin palës së dëmtuar këmbësorit A.... I..... që ka kontribut sekondar në aksident apo 30%. Nga procesverbali i Gjykatës Komonale Podujevë C.nr.229/09 të datës 28.09.2009 vërtetohet se pala paditëse ka arritur marrëveshje me palën e dëmtuar për kompensim dëmi në shumën prej 1.238.00 euro. Nga urdhër transferi i datës 09.02.20010 gjykata vërteton se paditësja, për dëmin jo material dhe material ka dhënë urdhër për transferimin e mjeteve departamentit të financave palës së dëmtuar familjes I.....në xhirollogarinë e të autorizuarit të tyre në shumën prej 1.238.00 euro. Gjykata, duke i vlerësuar provat materiale thënie në padi dhe në seancë të palës paditëse, përgjigjen në padi të të paditurit dhe deklarimit të të autorizuarit të tij në shqyrtim kryesor, vlerësoi se paditësja ka të drejtë në rimbursimin e dëmit nga i padituri ashtu që nga shuma e përgjithshme e paguar palës së dëmtuar prej 1.238.00 euro, sipas përgjegjësisë së konstatuar nga eksperti i komunikacionit ku i padituri mban përgjegjësi primare për shkaktimin e aksidentit, duke i zbritur pjesën e përgjegjësisë prej 30 % të kontributit të fëmiut në aksident apo shumën prej 371.4 euro, atëherë të paditurit i mbetet për pagesë shuma prej 866.6

euro, ndërsa refuzohet pjesa tjetër deri në shumën ku ka kontribuar fëmiu i mitur - këmbësori dhe atë prej 30% apo shuma prej 371.4 euro. Gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar pretendimin e të paditurit për sa i përket mungesës së bazës juridike të kërkesëpadisë, ngase baza juridike u vërtetua nga ekspertiza e komunikacionit e hartuar nga eksperti i komunikacionit, S.... B..... nga Prishtina me datë 16.10.2020 dhe raportit të Policisë nr.09-AR-00573 i datës 14.08.2009, ndërsa detyrimi i sigurimit të automjeteve ishte i rregulluar me dispozitat të Rregullit 3 të BQK-së, nenin 1.4, 1.5, 1.7, kurse tani me dispozitat ligjore të LSDA 2011. Po ashtu, gjykata e refuzoi si të pabazuar pretendimin e të autorizuarit të të paditurit se kërkespadia është e përfshirë në parashkrim sepse aksidenti ka ndodh me datë 14.03.2009, ndërsa padia e paraqitur në gjykatë me datë 14.05.2012, pas 3 vitesh, kjo për faktin se sipas dispozitës ligjore të nenit 380 al.3 dhe 4 të LMD-së 1978 apo nenit 357 paragrafi 1 e lidhur me nenin 362 paragrafi 3 dhe 4 të LMD-së të vitit 2012, kërkesa për rimbursim të siguruesit ndaj debitorit regresues në bazë të sigurimit nga autopërgjegjësia parashkruhet për 3 vite dhe atë nga data kur siguruesi e ka shpërblyer-paguar të dëmtuarin. Nga shkresat e lëndës vërtetohet se paditësja dëmin palës së dëmtuar ia ka paguar me datë 09.02.2010 dhe afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga kjo datë, ndërsa padia për rimbursim dëmi është paraqitur në gjykatë me datë 14.05.2012, andaj në rastin konkret nuk kemi parashkrim të padisë dhe kërkesëpadisë së paditëses. Në fund, gjykata e aprovoi pjesërisht kërkespadinë e paditëses duke e mbështetur vendimin e saj në nenin 17, 154 paragrafi 1, nenin 155, nenin 158, nenin 262 nenin 178, nenin 185, nenin 192 paragrafi 1, nenin 200 të LMD-së (viti 1978), nenin 4 të Rregullit në pajtim me Kompanitë e Sigurimit në Kosovë, nenin 3 të BQK-së tani e rregulluar dhe me dispozitat ligjore LSDA 2011 neni 18 lidhur me nenin 13 si dhe nenet 29 paragrafi 1 dhe 6, neni 32 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 277 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mori sipas nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, në ndërkohë që edhe gjendja faktike në këtë procedurë është provuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit për shkeljet që i referohen dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, e as shkeljeve të tjera nga neni 182 paragrafi 2 të LPK-së, pasi që dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, paragrafi 3, 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishtme të kërkesëpadisë së paditëses, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe

mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pa baza pretendimet ankimore të të paditurit i cili në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur për çështjen pa u mbështetur në ndonjë vendim gjyqësor të formës së prerë për sa i përket fajësisë së të paditurit apo kontributit të pjesëmarrëve në aksident, e kjo për faktin se me rastin e përcaktimit të bazës juridike të kërkesëpadisë dhe përgjegjësisë së të paditurit në aksident, gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë raportit të aksidentit të policisë të datës 14.03.2009 dhe ekspertizën e komunikacionit të përpiluar nga eksperti i komunikacionit S.... B..... me datë 16.10.2020, sipas të cilës ekspertizë i padituri ka përgjegjësi primare ngase ngasësi i automjetit (i padituri) është dashur ta ngadalsojë shpejtësinë në momentin kur e ka vërejtur rrezikun duke iu përshtatur lëvizjen e automjetit rregullave të komunikacionit në atë mënyrë që automjetin ta ndal në çdo kohë. Eksperti i komunikacionit ka konstatuar se ngasësi i automjetit (i padituri) ka pasur mundësi ta perceptojë këmbësorin në distancë rreth 25 metra, ku këmbësori ka lëvizur në rrugë nga ana e majtë në të djathtë duke kaluar rreth 3.5-4 metra në rrugë për 2.5 sekonda. Sipas ekspertizës së komunikacionit automjeti ka lëvizur me shpejtësi 40 km/h në pjesën e rrugës ku shpejtësia është e kufizuar në 40 km/h, mirëpo edhe pse nuk ka tejkallim të shpejtësisë, ngasësi i automjetit (i padituri) nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes sipas kushteve dhe rrethanave të krijuara në komunikacion. Në anën tjetër, për sa i përket këmbësorit (të dëmturit) eksperti ka vlerësuar se ka përgjegjësi sekondare ngase kalimin e rrugës do të duhej ta bënte në venkalimin për këmbësor dhe do të duhej ta bënte nën kujdesin e personit madhor duke i dhënë përparësi kalimit të mjeteve në rrugë. Gjykata e shkallës së parë ia fali besimin ekspertizës ngase është e hartuar në mënyrë profesionale me crast eksperti i komunikacionit ka dhënë konstatimin dhe mendimin e tij duke e arsyetuar në delatale, të cilën ekspertizë e pranon edhe Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, ndërsa në rastin konkret nuk ka qenë i domosdoshëm ekzistenca e vendimit të formës për konstatimin e fajësisë në kuptim të nenit 14 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e refuzon si të pa bazuar edhe pretendimin ankimor të të paditurit i cili në anksë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike ngase në rastin konkret nuk kemi ekspertizë mjeko ligjore për dëmet e shkaktuara edhe pse të njëjtat janë kompensuar nga paditësja, duke vë theksa të vecantë në faktin se kjo çështje është rigjykuar nga gjykata e shkallës së parë, ngase, Gjykata e Apelit, me Akvendimin Ac.Nr. 934/2017 të datës 09.03.2020 kishte aprovuar ankesën e paditëses duke e kthyer çështjen në rigjykim me arsyetimin se në çështjen në fjalë mungon ekspertiza nga lëmia e komunikacionit rrugor për të pasqyruar gjendjen reale sa i përket kontributit të pjesëmarrëve në aksident, andaj nuk ka qenë dhe nuk është kontestues fakti se nga ky aksident ka përsuar lëndime të lehta trupore i dëmtuari, A.. I....., fakt ky i provuar me ekspertizën mjekësore të përpiluar nga Dr. Xh..... S..... Ortoped-traumatolog me datë 30.08.2009, rrjedhimisht gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe dispozitat e procedurës kontestimore janë aplikuar drejtë.

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar pretendimin ankimor të palës së paditur thekson se nuk është kontestues fakti se aksidenti i komunikacionit ka ndodh me datë 14.03.2009, ndërsa

paditësja ka ushtruar padi për rimbursim dëmi ndaj të paditurit me datë 14.05.2012, mirëpo nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës së kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, andaj kjo gjykatë e pranon qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për arsyet si në vijim.

Sipas nenit 376 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (të vitit 1978-ngase ishte në fuqi në kohën e shkaktimit të aksidentit), ndërsa neni 357 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-077 parashihet se *“kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vite, nga dita kur i dëmtuari ka marrë dijani për dëmin dhe për personin i cili ka shkaktuar dëmin”*. Afatet e parashkrimit të kontratat për sigurimin janë përcaktuar me nenin 380 paragrafi 3 dhe 4 të LMD-së (1978), kurse neni 362 paragrafi 3 dhe 4 të LMD-së (tani) ku përcaktohet se *“kërkesat e sigurvecit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tri vite”*, kurse paragrafi 4 përcakton se *“nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari ose shpërblimin e ka marrë prej tij parashkrimi i kërkesës të të siguruarit ndaj sigurvecit fillon nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar rrugë gjyqësore, shpërblimin nga i siguruari respektivisht kur i siguruari t’ia ketë shpërblyer dëmin”*. Në këtë rast, paditësja, sipas urdhërtransferit të datës 09.02.2010 ka transferuar shumën e gjykuar të dëmtuarit, andaj nga momenti kur paditësja e ka ekzekutuar pagesën tek pala e dëmtuar, të njëjtës iu është krijuar e drejta për të kërkuar ri mbursim nga i padituri sipas rregullit 3 të BQK-së, ndërsa neni 18 paragrafi 4 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto- përgjegjësia Nr. 04/L-018, ku është përcaktuar se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*, andaj edhe rrjedha e afatit të parashkrimit të drejtës për ri mbursim fillon nga ky moment, ngase kërkesa është bërë e arritshme sepse deri sa nuk ka paguar kurrfarë kompensimi të dëmtuarit nuk mund edhe të kërkojë ri mbursimin dhe vetëm pasi ka bërë pagesën e dëmit paditësja e ka kuptuar saktësisht shumën që do të duhej të ri mbursohej, prandaj kërkesëpadia e paditëses për ri mbursim dëmi nuk është e parashkruar.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, gjykata ka vlerësuar se e njeja është gjykuar drejtë sipas LMD-së së vjetër të vitit 1978, përkatësisht neni 277 të LMD-së, pasi paditësja e ka kompensuar palën e dëmtuar me datë 09.02.2010, ndërsa në këtë periudhë ka qenë në fuqi ligji i vjetër. Si rrjedhojë, edhe koha llogaritjes së saj është bërë në përputhje me mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr.265/2020, datë 02.12.2020.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat neni e 449 dhe 450 të LPK-së.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar si të drejtë dhe të rregullt vendimin e gjykatës së shkallës së parë në tërësinë e tij, ka ardhur në përfundim se ankesa e të paditurit është tërësisht e papabuar, për çka edhe është vendosur që të njëjtën ta refuzoj.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të

Numri i lëndës: 2020:049861
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05714273

dispozitive nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2105/2021 me datë 21.05.2024

**Kryetari i Kolegjit,
Ardian Ajvazi**